



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+ në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës (Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit), në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, **të vitit të katërt – Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, të vitit të parë Master – Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.**

**Kohëzgjatja e bursave:**

- **01.04.2024 deri 15.08.2024**

**Fusha e studimit:** Arkitekturë, Urbanistikë, Inxhinieri Elektrike, Teknologji Informacioni.

- Architecture (DIA), M.A. (max. 2 students) Campus Dessau
- Landscape Architecture (M. A.) (max. 1 student) Campus Bernburg
- Architectural and Cultural Heritage (Master of Arts) (max. 1 student) Campus Dessau
- Electrical and Computer Engineering (M. Eng.) (max. 2 students) Campus Köthen

Numri total i studentëve: **4**

**Duke u inkurajuar edhe nga politikat sociale të Anhalt University of Applied Sciences, përparësi do të kenë studentët me aftësi të kufizuara dhe studentët me probleme sociale.**

1. Studentët me aftësi të kufizuara, studentët e pafavorizuar në aspektin social, ose studentët që vijnë nga familje pa formim akademik, kanë të drejtë për një shtesë sociale prej 250 € në muaj. Kjo do të rrisë tarifën mujore nga 850 në 1100 euro
2. Studentët që bien dakord të udhëtojnë në Gjermani duke përdorur mjete të qëndrueshme transporti (autobus, tren) do të marrin një mbështetje më të madhe udhëtimi (320 EUR në vend të 275 EUR).

**Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*



**Key Action 1  
– Mobility for learners and staff –**

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli i kërkuar është nga B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Mobility Plan’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit. në Anhalt University of Applied Sciences, Gjermani lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

*Dokumenti ‘Learning Agreement’ tek seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin e ‘Learning Agreement’, ju lutemi klikoni në link-un:  
[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Për t’u njohur me programet e lëndëve, ju lutemi klikoni në link-un:  
**FAQ Incoming:** <https://www.hs-anhalt.de/en/international/studyexchange-and-internship-abroad/erasmus/incoming-students.html>

**Afati për aplikim: Deri më 19 dhjetor 2023**

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit, mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) , [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al) .